



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT

PËR

MONITORIMIN E PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT NË

MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Tiranë, Shtator 2018

RAPORT

Për përmbylljen e procesit të monitorimit në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të ristrukturimit, në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetjeje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet urdhrorit nr. 85, datë 9.10.2017, “Për fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylljes dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave”, ka vendosur fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës.

Bazuar në pikën 2, të tabelës nr. 1, bashkëlidhur urdhrorit më sipër, u ngrit grupi i punës me përbërje inspektorët, Aida Dobjani dhe Valentina Kolleshi, të cilët janë autorizuar nga Komisioneri për të monitoruar procesin e ristrukturimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, i cili filloi në datën 5.2.2018.

Objekti i monitorimit në këtë institucion është procedura e ristrukturimit, që përfshin të gjitha proceset e legjislationit për nëpunësin civil, që rregullojnë këtë aspekt, ndër të cilat përmendim, hartimin e përshkrimeve të reja të punës; krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit, aktet administrative për propozimin e transferimeve të Komisionit të Ristrukturimit; verifikimi i propozimeve për sistemimin e nëpunësve dhe miratimi i tyre nga Departamenti i Administratës Publike; evidentimi i rasteve të lirimit nga shërbimi civil, respektimi i afateve procedurale nga ana e aktorëve që marrin pjesë në këtë procedurë, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës përpunoi të dhënat dhe përgatiti raportin e monitorimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si më poshtë:

Qëllimi i monitorimit

Qëllimi i realizimit të këtij procesi është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e procesit të ristrukturimit.
- Paralajmërimin e njësisë përgjegjëse, institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e monitorimit

Si metodë pune është përdorur verifikimi i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në sektorin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si dhe Departamentit të Administratës Publike. Konkretisht, grupi i punës realizoi veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u organizua një takim dhe bashkëbisedim, në datën 5.2.2018, me ******, me detyrë “Drejtor”, i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, me të cilin u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e procesit, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të punës për verifikim. Person i kontaktit me grupin e punës në këtë institucion, u caktua nëpunësja ******, e cila kryen detyrën “Specialist”, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore.
- U administrua gjithë dokumentacioni shkresor i konsideruar i nevojshëm për realizimin e këtij monitorimi, e konkretisht: struktura aktuale dhe struktura mëparshme; listë prezencat para dhe pas ristrukturimit; disa modele të formatit të përshkrimeve të punës; dokumentacioni që materializon procedurën e ristrukturimit; aktet administrative që materializojnë vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe të Departamentit të Administratës Publike; si dhe çdo dokumentacion tjetër që ndihmon realizimin e verifikimit të procesit.

Përmbajtja e Raportit:

Me miratimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, që përkon me mbarimin e procesit zgjedhor të vitit 2017, rezulton se është riorganizuar i gjithë aparati shtetëror. Nga ky proces, u shkrinë 8 ministri të mëparshme, funksionet e të cilave iu bashkuan 11 ministrive të mbetura, si dhe u shtuan 2 ministri të reja, duke e reduktuar numrin nga 19 ministri, që ishin para zgjedhjeve, në 13 ministri.

Për pasojë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila është subjekt i këtij monitorimi, si dhe gjithë ministrinë e tjera, kaluan në proces ristrukturimi.

Në përfundim të procesit të monitorimit rezultoi si më poshtë:

I. Struktura organizative e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme para dhe pas procesit të ristrukturimit.

Emërtesa e këtij institucioni “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme” është miratuar me Dekret të Presidentit të Republikës nr.10604, datë 10.9.2017 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”. Me vendimin nr. 500, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, është përcaktuar misioni dhe fusha e përgjegjësisë shtetërore e kësaj ministrie, duke përfshirë në veprimtarinë e saj tashmë edhe fushën e përgjegjësisë shtetërore të ish Ministrisë së Integritimit Evropian.

Më pas, me urdhrin nr. 159, datë 5.10.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, është miratuar struktura e organizimit të brendshëm e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila ka shfuqizuar edhe Urdhrin nr. 40, datë 15.3.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Integritimit Evropian”.

Struktura dhe organika e re, në përmbajtjen e saj, ka të evidentuara në mënyrë të qartë pozicionet e punës të kategorizuar sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar:

- ✓ për funksionarët politikë të ministrisë;
- ✓ pozicionet e punës ndaj të cilëve zbatohet ligji për nëpunësin civil;
- ✓ pozicionet e punës që kryejnë funksione administrative.

Ndërkohë, në strukturë, është bërë edhe kategorizimi i personelit në përputhje me nenin 34, të ligjit nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, konkretisht në:

- ✓ diplomatë të karrierës;
- ✓ nëpunës civilë;
- ✓ personeli teknik dhe i shërbimit.

Specifike e kësaj ministrie është fakti që, diplomatët e karrierës, përveç statusit të diplomatit kanë edhe statusin e nëpunësit civil, ndërsa, pozicionet e punës, ku nëpunësit gëzojnë vetëm statusin e nëpunësit civil, janë të përcaktuara në nenin 56, të aktit ligjor si më sipër.

Pranimi në këtë ministri, ose siç përcaktohet në nenin 36 të ligjit, pranimi në Shërbimin e Jashtëm, bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil dhe në këtë ligj.

Në rastet kur pozicioni i punës ka edhe statusin e diplomatit, sipas nenit 39, të ligjit, *pas konfirmimit si nëpunës civil, nëpunësi bën betimin dhe fiton statusin e diplomatit të karrierës dhe gradën diplomatike “Atashe”.*

Përsa i përket transferimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, ndryshe nga sa parashikohet në ligjin për shërbimin civil, sipas nenit 37, të ligjit për shërbimin e jashtëm, këto procedura, të cilat janë të përcaktuara në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm, bëhen me Urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme, në bazë të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm.

Gjithashtu në këtë ligj, përcaktohet edhe trajtimi financiar i personelit të Shërbimit të Jashtëm, ku sipas nenit 53, të tij, paga e diplomatit të karrierës, i cili punon në Ministrinë e Punëve të Jashtme, caktohet në bazë të gradës diplomatike personale dhe funksionit që kryen.

Në këto kushte, si struktura ashtu edhe vetë procesi i ristrukturimit, reflektojnë edhe këto përcaktime të ligjit për shërbimin e jashtëm. Në rastin konkret, në strukturën e re të miratuar, për pozicionet e punës që gëzojnë vetëm statusin e nëpunësit civil, është përcaktuar kategoria e pagës sipas klasifikimit të pozicioneve në shërbimin civil, ndërsa, për pozicionet e punës që kanë edhe statusin e diplomatit, niveli i pagës është i lidhur me këtë status.

Më poshtë po analizojmë strukturën me të cilën ka funksionuar institucioni deri në momentin ristrukturimit, si dhe strukturën e re, miratimi i të cilës është shoqëruar me shtim të vendeve të punës dhe ndryshim apo ristrukturim të vendeve ekzistuese.

Struktura para ristrukturimit, e miratuar me urdhrin nr. 41, datë 23.3.2015, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Jashtme”, e ndryshuar, (ndryshuar me urdhrin nr. 19, datë 28.2.2017 të Kryeministrit), kishte gjithsej **150 pozicione pune**, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ **10** pozicione pune janë *funksionarë politikë* (1 Ministër; 3 Zëvendësministër; 1 Drejtor Kabineti; 5 Këshilltarë);
- ✓ **119** pozicione pune janë *pjesë shërbimit civil*;
- ✓ **21** pozicione pune janë *punonjës administrativë* (7 sekretare; 1 magazinier; 1 fotograf; 4 pastrues; 1 punëtor mirëmbajtje; 7 shoferë).

Struktura pas ristrukturimit, e miratuar me urdhrin nr. 159, datë 5.10.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, ka miratuar gjithsej **195 pozicione pune**, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ **11** pozicione pune janë *funksionarë politikë*, (1 Ministër; 3 Zëvendësministër; 1 Drejtor Kabineti; 6 Këshilltarë);
- ✓ **163** pozicione pune janë *pjesë e shërbimit civil*;
- ✓ **21** pozicione pune janë *punonjës administrativë*, (7 sekretare; 1 magazinier; 1 fotograf; 4 pastrues; 1 punëtor mirëmbajtje; 7 shoferë).

Duke krahasuar strukturën e vjetër me strukturën e re, konstatohet *senumri i përgjithshëm i vendeve të punësishte 150* dhe është bërë *195*, ndërsa *numri i pozicioneve të shërbimit civil ishte 119 dhe është bërë 163*, pra, *janë shtuar 44 pozicione pune të shërbimit civil*.

Konstatohet se, gjatë procesit të ristrukturimit, janë sistemuar **162** nëpunës civilë, ndërsa **1** pozicion pune i kategorisë ekzekutive, është vend i lirë (Specialist në Sektorin e të Drejtës Evropiane, Drejtoria e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane).

Për shkak të miratimit të strukturës së re, pozicionet e shërbimit civil kanë pësuar ndryshime jo vetëm në numër, por ka ndryshuar edhe mënyra e organizimit tënjësive organizative pjesë përbërëse e institucionit.

Mënyrën e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës së re krahasuar me strukturën e vjetër, po e paraqesim në mënyrë tabelare si më poshtë:

Pozicionet e shërbimit civil sipas emërtesës	Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së vjetër)	Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së re)
Pozicione pjesë e TND		
Sekretar i Përgjithshëm	1	1
Drejtor i Përgjithshëm	2	2
Drejtor	16	16
Përgjegjës Sektor	20	31
Specialist	80	113
Nëpunës civil gjithsej	119	163

Pra, nga sa më sipër, konstatohet një shtim i numrit të sektorëve dhe është rritur numri i pozicioneve të punës të kategorisë ekzekutive “Specialist”.

Gjithashtu konstatohet se, në strukturën e re, është shtuar një drejtor i re, *Drejtoria e Fondeve të BE-së*, punonjësit e të cilës, janë transferuar nga Ministria e Integritimit Evropian. Kjo drejtor ka në përbërje të saj 5 sektorë, gjithsej 20 nëpunës (1 Drejtor, 5 Përgjegjës Sektor, 14 Specialistë). Theksojmë faktin se, punonjësit e kësaj drejtorie gëzojnë vetëm statusin e nëpunësit civil.

Ndërkohë, sipas strukturës së vjetër, *Akademia Diplomatike*, ishte e organizuar në nivel *drejtorie*, e përbërë nga 1 Drejtor dhe 2 Specialistë, me varësi direkte nga Sekretari i Përgjithshëm, ndërsa, sipas strukturës së re, kjo njësi, është e organizuar në nivel *sektori*, e përbërë nga 1 Përgjegjës Sektor dhe 2 Specialistë, e përfshirë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Për rrjedhojë, numri i pozicioneve “Drejtor”, ka mbetur i njëjtë edhe në strukturën e re, pas ristrukturimit.

Nga gjithë sa më sipër, rezulton se, institucioni ka kaluar në proces ristrukturimi, në kushtet kur konstatohet plotësimi i kërkesave ligjore për të patur një proces të tillë:

- a) janë shtuar vendet e punës pjesë e shërbimit civil;
- b) janë ristrukturuar vendet e punës ekzistuese;
- c) për kryerjen e funksioneve administrative të institucionit është bërë e nevojshme një rishpërndarje e burimeve njerëzore.

II. Procedurat e realizuara për sistemimin e nëpunësve civilë në strukturën dhe organikën e re të institucionit

Nga këqyrjaedokumentacionit të administruar rezulton se, pas hyrjes në fuqi të urdhëritnr. 159, datë 5.10.2017, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme*”, njësia përgjegjëse DAP dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit, si dhe nëpunësit përgjegjës të ngarkuar me detyra specifike gjatë procesit të ristrukturimit, kanë nisur kryerjen e procedurave të domosdoshme administrative, të parashikuara nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat rregullojnë në mënyrë të shprehur procesin e ristrukturimit.

Konstatohet se, menjëhere pas miratimit nga Kryeministri të strukturës dhe organikës së re, njësia përgjegjëse DAP, ka njoftuar individualisht, në mënyrë shkresore të gjithë nëpunësit civil të aparatit të ish Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit. Mëpasëstë vepruar për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, i cili ka shqyrtuar mundësinë e ripozicionimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese. Më tej, njësia përgjegjëse DAP, ka kryer procedurat administrative për konfirmimin e propozimeve të paraqitura nga komisioni si dhe njoftimin e vendimit të transferimitnëpunësve përkatës. Në mënyrë më të detajuar konstatojmë si më poshtë:

➤ *Krijimi i Komisionit të Ristrukturimit*

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së re, Departamenti i Administratës Publike, me urdhrin nr. 12/3, datë 9.10.2017, “*Për krijimin e komisionit të ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisëpër Evropën dhe Punët e Jashtme*”, ka krijuar komisionin e ristrukturimit të përbërë nga:

- ***** , Specialiste në Sektorin e Performancës dhe Programeve Trajnuese, në Drejtorinë e Zhvillimit të Institucioneve të Pagave, në Departamentin e Administratës Publike- kryetar;
- ***** , Sekretar i Përgjithshëm- anëtar;
- ***** , Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse - anëtar.

Komisioni i ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është ngritur në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 50, të ligjit, ku përcaktohet se “Në çdo rast mbyllje apo ristrukturimi krijohet një komision ristrukturimi. ...”

Numri i anëtarëve të komisionit është në përputhje me përcaktimet e pikës 17, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë” ku parashikohet se, “Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe krijohet nga njësi përgjegjëse sipas rastit”.

Nëcaktimine drejtuesit dhe anëtarëve të komisionit, janë respektuar parashikimet e pikës 5, të nenit 50, të ligjit, si dhe rregullat e vendosura nga udhëzimin nr. 1, datë 1.3.2016, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

➤ ***Shqyrtimi i mundësisë për sistemimin e nëpunësve civilë në strukturën e re***

Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; kreut II, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; rregullave të parashikuara në pikat nga 4 deri në 17, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016 të DAP, si dhe duke pasur parasysh faktin se, fusha e veprimit të ish-Ministrisë së Integritimit Evropian, është përfshirë në fushën e përgjegjësisë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për ripozicionimin e çdo nëpunësi civil në strukturën e re, komisioni i ristrukturimit, ka ndjekur hapat si më poshtë:

Së pari, komisioni i ristrukturimit, ka bërë krahasimin e strukturës së re me strukturat ekzistuese të ish-MPJ dhe ish-MIE, për të evidentuar njësitë organizative të krijuara rishtas, ato që suprimohen dhe ato që ndryshojnë, si dhe pozicionet që preken nga ristrukturimi, ato që krijohen dhe ato që suprimohen.

Nga analiza e strukturës së MEPJ, rezulton se, funksionet e ish-MIE, janë përfshirë në vetëm 3 drejtori, të cilat janë organizuar si më poshtë:

- ✓ **Drejtorja e BE-së**, që është drejtori aktuale e MEPJ, është riorganizuar, duke bashkuar strukturën ekzistuese të MEPJ (Drejtorja e BE-së), me funksionet teknike paralele që kanë qenë ushtruar nga ish-Ministria e Integritimit Evropian (Drejtorja për Politikat Sektoriale).

Drejtorja e BE-së, ka qenë e organizuar me 2 sektorë, ndërsa pas ristrukturimit është organizuar me **4 sektorë** (1 Drejtor, 4 Përgjegjës Sektor, 11 Specialistë).

Evidentohet fakti se, pozicioni “Drejtor” dhe “Sektori i Dialogut Politik” (strukturë ekzistuese e MEPJ, e përbërë nga 1PS + 3S), kanë status diplomat. Në këto rrethana,

komisioni i ristrukturimit, ka shqyrtuar mundësinë dhe ka sistemuar nëpunësit në 3 pozicione “Përgjegjës Sektori” dhe 8 pozicione “Specialist”.

- ✓ **Drejtoria e Fondeve të BE-së**, është parashikuar në strukturën e re të MEPJ, në të cilën janë bashkuar funksionet e dy drejtorive të ish-MIE (Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së dhe Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial).

Kjo drejtori është e organizuar me këto pozicione pune: 1 Drejtor, 5 Përgjegjës Sektori dhe 14 Specialistë. Konstatohet se, komisioni i ristrukturimit, në këto pozicione pune, ka sistemuar nëpunësit civilë të ish-MIE, përveç 1 pozicioni “Specialist” në Sektorin e të Drejtës Evropiane, i cili rezulton vend i lirë.

- ✓ **Drejtoria e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane**, e cila ka qenë strukturë ekzistuese e MEPJ, është riorganizuar, duke bashkërenduar punën e saj me Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit në ish-MIE.

Evidentohet fakti se, pozicioni “Drejtor” dhe “Sektori i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve” (strukturë ekzistuese e MEPJ, e përbërë nga 1PS + 4S), kanë status diplomat. Në këto rrethana, komisioni i ristrukturimit, ka shqyrtuar mundësinë dhe ka sistemuar nëpunësit në 2 pozicione “Përgjegjës Sektori” dhe 10 pozicione “Specialist”.

Së dyti, komisioni i ristrukturimit, ka verifikuar përshkrimet e punës për pozicionet e krijuara, të mbetura apo të ristrukturuara. Rregullat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, miratimin dhe bërjen efektive të strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore, janë të përcaktuara në pikat nga 30 deri në 40, të vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”. Ndër të tjera këto rregulla parashikojnë se, përshkrimet e punës për çdo pozicion pune të strukturës së re, i bashkëlidhen propozimit për ndryshimin e strukturës, që institucioni i dërgon DAP. Më konkretisht, në shkronjën “c”, të pikës 33, është parashikuar:

“Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike të dhënat e mëposhtme:

...(shkronja c) “Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi”. ...

Detyrimin për hartimin e përshkrimeve të punës në momentin kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, e parashikon edhe vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave “Përpërshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Në mënyrë të shprehur pika 14, e kreut IV, të këtij akti nënligjor parashikon:

“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Në respektim të rregullave të vendosura nga aktet nënligjore si më sipër, subjektet e ngarkuara me përgjegjësinë e hartimit, miratimit e administrimit të përshkrimeve të punës siç janë: *njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, analisti i punës, eprori direkt i pozicionit respektiv të punës, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe njësia përgjegjëse*, duhet të hartonin përshkrime të reja pune, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil të strukturës së re.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, fillimisht ka përgatitur një ekstrakt të përshkrimeve të punës, si dhe kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi për ndryshimin e organizimit të brendshëm të institucionit, të cilin, bashkë me relacionin propozues për ndryshimin e strukturës organike ia ka dërguar Departamentit të Administratës Publike. Më pas, këto materiale i janë vënë në dispozicion Komisionit të Ristrukturimit, i cili nga verifikimi i tyre ka evidentuar kriteret e veçanta për çdo pozicion pune të shërbimit civil.

Komisioni në punën e tij, është asistuar nga njësia e personelit e institucionit, e cila ka kryer detyrat e Sekretarisë Teknike. Pas marrjes së konfirmimit nga Departamenti i Administratës Publike, lidhur me propozimet për ripozicionimin e të gjithë punonjësve në strukturën e re, njësia e burimeve njerëzore, ka finalizuar procesin e miratimit të përshkrimeve të reja të punës.

Në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion, u konstatua se, përshkrimet e punës, janë të hartuara sipas formatit që parashikon lidhja 4, bashkëlidhur vendimit nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Përpërshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar. Përshkrimet e reja të punës janë të miratuara nga nëpunësi civil përkatës, eprori direkt dhe Sekretari i Përgjithshëm, sipas përcaktimeve të kreut IV, *“Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”*, i VKM nr. 142, dt. 12.3.2014, i ndryshuar, i cituar si më sipër.

Së treti, për të arritur në një vendimmarrje, komisioni i ristrukturimit, ka verifikuar dosjet personale të nëpunësve civilë, me qëllim verifikimin e plotësisht të kërkesave të posaçme që lidhen me arsimimin, kualifikimet, përvojën në punë, vlerësimin e rezultateve në punë, duke aplikuar sistemin e vlerësimit me pikë, bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 1.3.2016, të DAP.

Në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re të MEPJ, për shkak të kalimit të funksioneve të ish-MIE kësaj ministrie, komisioni i ristrukturimit, për të mundësuar sistemimin e nëpunësve ekzistues, ka verifikuar plotësimin e kërkesave specifike të

pozicionit të lirë të së njëjtës kategori sipas precedencës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit, ku përcaktohet se, transferimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, për shkak të ristrukturimit të institucionit, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditjeje:

- a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar;
- b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkruar apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi;
- c) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar;
- d) në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Më tej, pika 3 e nenit 50 të ligjit, përcakton se:

“... Komisioni shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. ...”.

Në mbështetje të nenit 50, të ligjit, ka dalë vendimi nr. 125, datë 17.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil”. Ky akt nënligjor, në pikën 18, të kreut II, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, përcakton kriteret në të cilat mbështetet komisioni i ristrukturimit në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit. Më tej, në pikën 19, përcaktohen kriteret, në të cilat komisioni mbështet vendimmarrjen për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Më konkretisht, dispozitat e aktit nënligjor, si më sipër përcaktojnë:

(Pika 18) “Komisioni i ristrukturimit në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënat e nëpunësve civil, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit. Vendimi është individual për çdo nëpunës civil”.

(Pika 19) “Komisioni i ristrukturimit, në vendimin e tij për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet mbi këto kriteret:

- a) Vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil;
- b) Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë;
- c) Vlerësimin e fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitim dhe përditësimin e njohurive shtesë”.

Në zbatim të detyrave të përcaktuara nga dispozitat ligjore e nënligjore si më sipër, Komisioni ka verifikuar dosjet personale të nëpunësve civilë, me qëllim verifikimin e plotësisimit të kërkesave të posaçme për nivelin e diplomës së arsimit të lartë, profilin e arsimit të lartë, kualifikimet, përvojën në punë, vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe gjendjen shëndetësore të provuar me vërtetimin mjekësor përkatës dhe nëpunësit me largësi vendbanimi më shumë se 45 km nga institucioni, pasi këto dy të fundit, janë të përmendura nga pika 21, si arsye e nëpunësit për të refuzuar vendimin e Komisionit.

Mbi bazën e krahasimit dhe vlerësimin të informacionit të mbledhur, komisioni ka vendosur për transferimin e përhershëm, pra, sistemimin në strukturën e re, ose përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit/mbylljes së institucionit.

Evidentojmë faktin se, nga Komisioni i Ristrukturimit *nuk janë trajtuar kategoritë e nëpunësve si më poshtë:*

- ✓ **3** nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese, anëtarë të TND-së.

Në këtë rast, për menaxhimin dhe lëvizjen e kësaj kategorie nëpunësish zbatohen përcaktimet e nenit 30, pika 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe rregullat e kreut VII, me titull “Caktimi i anëtarit të TND-së në një pozicion të rregullt”, pika 1, 2 e 3, të Vendimit nr.118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.

- ✓ **65** nëpunës civilë të MEPJ, të cilët kanë edhe statusin e diplomatit.

Për këta nëpunës, janë zbatuar kërkesat e nenit 37, të ligjit nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se, *transferimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë bëhen me urdhër të Ministrisë të Punëve të Jashtme, në bazë të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm.* Në rastin konkret, pas miratimit të strukturës së re të ministrisë, me akt të dalë nga Sekretari i Përgjithshëm, këta nëpunës, janë njoftuar në lidhje me sistemimin e tyre pas ristrukturimit dhe më pas ka dalë Urdhri i Ministrisë në lidhje me emërimin e tyre në detyrë. Për këtë proces, sipas përcaktimeve në ligj, është njoftuar edhe Departamenti i Administratës Publike.

- ***Transferimi i përhershëm i nëpunësve civilë, në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit.***

Në përfundim të veprimeve administrative të kryera për verifikimin e kërkesave të posaçme të parashikuara për çdo pozicion të shërbimit civil si dhe verifikimit të të dhënave individuale të nëpunësve civilë në pritje për transferim, Komisioni i

Ristrukturimit, nëpërmjet vendimit nr. 6576, datë 16.11.2017 dhe vendimit nr. 6576/98, datë 10.1.2018, i ka propozuar Departamentit të Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit në 104 raste.

Pasi ka shqyrtuar propozimet e komisionit të ristrukturimit, DAP, me vendimin nr.6576/1, datë 16.11.2017 dhe vendimin nr. 6576/99, datë 10.1.2018, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në të gjitha rastet e propozuara nga komisioni i ristrukturimit.

Në rastin konkret është vepruar si më poshtë:

- ✓ Për **47 nëpunës** të MEPJ, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e re të MEPJ, që në këtë rast është institucioni ku nëpunësi ishte i emëruar (*është vepruar sipas precedencës së përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 50 të ligjit*).
- ✓ Për **47 nëpunës** të ish-MIE, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e re të MEPJ, që në këtë rast, është institucioni që ka marrëfunksionet që kryente më parë nëpunësi (*sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 50 të ligjit*).
- ✓ Për **10 nëpunës** të ish-MIE, është bërë transferimi i përhershëm në institucione të tjera të shërbimit civil (*sipas shkronjës “ç”, pika 2, të nenit 50, të ligjit*). Në rastin konkret janë sistemuar:

- 1 nëpunës në Ministrinë e Drejtësisë;
- 2 nëpunës në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë;
- 4 nëpunës në Agjencinë Kombëtare Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
- 1 nëpunës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës;
- 1 nëpunës në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;
- 1 nëpunës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Nga verifikimi në tërësinë e tyre të këtyre materialeve shkresore rezultoi se:

- ✓ në **91 raste**, nëpunësit janë sistemuar në pozicione të shërbimit civil të të njëjtës kategori;
- ✓ në **1 rast**, nëpunëscivil i kategorisë së mesme drejtuese është sistemuar në pozicion të kategorisë së ulët drejtuese me pëlqimin paraprak të tij;
- ✓ në **3 raste**, nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese janë sistemuar në pozicione të kategorisë ekzekutive me pëlqimin paraprak të tyre;
- ✓ në **9 raste**, nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive kanë pësuar ndryshim në nivelin e kategorisë. Edhe në këtë rast, sistemimi është bërë me pëlqimin paraprak të tyre.

Konstatohet se, në të gjitha rastet, transferimi i nëpunësve është bërë sipas precedencës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50 të ligjit.

➤ ***Emërim në njëpozicion të mesëm drejtues, të anëtarit të TND-së.***

Konstatohet se, nëpunësja ******, e cila ka qenë në pozicionin *Sekretar i Përgjithshëm* në ish-MIE, anëtar i TND-së, me aktin nr. 5929/1, datë 9.10.2017, të DAP, është liruar nga pozicioni i rregullt *Sekretar i Përgjithshëm*, dhe është regjistruar nga njësia përgjegjëse (DAP) në “*listën e anëtarëve të TND-së, në pritje për t’u caktuar në një pozicion të rregullt të nivelit të lartë drejtues*”.

Më pas, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 6723/3, datë 19.12.2017, e ka emëruar në pozicionin e nivelit të mesëm drejtues, “*Drejtor i Drejtorisë së Fondeve të BE-së*”, në MEPJ, pas dhënies së pëlqimit të shprehur nga ana e saj. Në këtë rast, janë zbatuar përcaktimet e pikës 3, të nenit 30, të ligjit, ku parashikohet se, *një anëtar i TND-së mund të emërohet edhe në një pozicion të kategorisë së mesme drejtuese, me pëlqimin e tij dhe të DAP-it.*

Konstatohet se, në lidhje me emërimin e saj, janë zbatuar procedurat e përcaktuara në pikën 7 dhe 8, Kreu VII, të Vendimit nr.118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar.

➤ ***Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.***

Nga verifikimet e kryera rezulton se, për 13 nëpunës civilë të ish-MIE, Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit. Në këtë rast bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- ✓ ******, “*Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Territorial*”, në ish-MIE, me vendimin nr. 501, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ******, “*Specialist në Sektorin e Gjqësorit, të Drejtave të Njeriut dhe Administratës Publike*”, në Drejtorinë për Politikat Sektoriale, në ish-MIE, me vendimin nr. 502, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ******, “*Drejtor i Drejtorisë së Financës*”, në ish-MIE, me vendimin nr.503, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ******, “*Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe Shërbimeve*”, në ish-MIE, me vendimin nr.504, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

- ✓ ***** , “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Prokurimit”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe Shërbimeve, në ish-MIE, me vendimin nr.505, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ***** , “Drejtor i Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Sekretariatit Evropian”, në ish-MIE, me vendimin nr.506, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ***** , “Drejtor i Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së”, në ish-MIE, me vendimin nr.507, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ***** , “Drejtor i Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit të BE-së”, në ish-MIE, me vendimin nr.508, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ***** , “Specialist në Sektorin për Asistencën e BE-së, Monitorimin e Vlerësimit”, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në ish-MIE, me vendimin nr.509, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ***** , “Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm”, në ish-MIE, me vendimin nr.510, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ***** , “Përgjegjës i Sektorit Juridik”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe Shërbimeve, në ish-MIE, me vendimin nr.511, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ***** , “Përgjegjës i Sektorit të Shoqërisë Civile, Strategjisë, Koordinimit, Trajnimit IE dhe Ngritjes së Kapaciteteve”, në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Sekretariatit Evropian, në ish-MIE, me vendimin nr.512, datë 4.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ ***** , “Specialist në Sektorin për Asistencën e BE-së, Monitorimin dhe Vlerësimit”, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në ish-MIE, me vendimin nr.10/1, datë 15.1.2018, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

Në të gjitha këto raste, me qëllim shqyrtimin e mundësisë së transferimit ose përfundimit të marrëdhënieve të punës, Komisioni i Ristrukturimit, ka marrë në shqyrtim:

- Strukturën dhe organikën ekzistuese të ish-MIE dhe të ish-MPJ;
- Strukturën dhe organikën e re të MEPJ;
- Të dhënat individuale të nëpunësve civil (dosja individuale);
- Kriteret specifike të vendeve vakante ekzistuese apo të krijuara/prekura si pasojë e ristrukturimit.

Pas vlerësimit, Komisioni i Ristrukturimit, ka arritur në përfundimin se, sistemimi ishte i pamundur, duke shqyrtuar mundësitësi më poshtë:

- Sistemimi në MEPJ, ka qenë i pamundur për shkak të specifikës së pozicioneve të punës në këtë ministri, ku, me përjashtim të funksioneve mbështetëse, pjesa tjetër funksionon sipas ligjit nr. 23/2015, “*Për shërbimin e jashtëm në RSH*”.
- Sistemimi nënjë institucion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, ishte i pamundur pasi, në kuadër të miratimit të Këshillit të Ministrave, 5 ministri të linjës u shkurtuan, ishin 16 ministri dhe u miratuan 11 ministri. Ky proces u shoqërua me shkurtim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të shërbimit civil;
- Sistemimi në institucionet e shërbimit civil në varësi të ministrisë ka qenë i pamundur, pasi ish-MIE dhe ish-MPJ, nuk kanë institucione varësie pjesë të shërbimit civil. Nga ana tjetër, asnjë prej institucioneve të tjera të varësisë, nuk u përfshinë në procesin e ristrukturimit.

Për këto arsye, në të gjitha rastet, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke i njohur nëpunësve të drejtat e përcaktuara në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë.

Bazuar në vendimin e Komisionit të Ristrukturimit të MEPJ, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, ka nxjerrë vendimin e lirimit nga shërbimi civil, në të gjitha rastet e sipërpërmendura.

Konstatohet se, në 5 raste, Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak se, nuk ekziston më Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- ✓ *****, “*Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Sigurisë*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe TI, në ish-MPJ, me vendimin nr. 16738, datë 24.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ *****, “*Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Sigurisë*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe TI, në ish-MPJ, me vendimin nr. 16740, datë 24.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ *****, “*Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Sigurisë*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe TI, në ish-MPJ, me vendimin nr. 16742, datë 24.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ *****, “*Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit*”, në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Sekretariatit

Evropian, në ish-MIE, me vendimin nr. 16739, datë 24.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

- ✓ *****, “*Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit*”, në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Sekretariatit Evropian, në ish-MIE, me vendimin nr. 16741, datë 24.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

Sistemimi i këtyre nëpunësve ka qenë i pamundur pasi, në strukturën dhe organikën e re të miratuar për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe nëministrinë e tjera të linjës, nuk ekziston më asnjë njësi organizative e dedikuar për kryerjen e funksioneve të menaxhimit TIK. Realizimi i këtyre funksioneve për ministrinë, do të bëhet nga një njësi organizative pjesë e strukturës dhe organikës së re të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të miratuar me urdhrin nr. 177, datë 10.10.2017, institucion, i cili nuk është pjesë e shërbimit civil.

Në kushte të tilla, kur janë shkurtuar/suprimuar pozicionet e punës të dedikuara për kryerjen e funksioneve të menaxhimit TIK, për nëpunësit që mbanin këto pozicione pune, Komisioni, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil dhe më pas ka dalë akti i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit për lirim nga shërbimi civil.

Nga përmbajtja e këtyre akteve konstatohet se, nuk janë parashikuar të drejtat e përcaktuara në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë. Por, kjo mangësi, është rregulluar nëpërmjet një “*Memorandumi për vendimmarrje*”, drejtuar Drejtorisë së Financës nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me dëmshpërblimin pas largimit nga shërbimi civil.

III. Raste të refuzimit të vendimit të transferimit si dhe të ankimit në rrugë administrative dhe gjyqësore të vendimit të lirit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Gjatë procesit të ristrukturimit, në rastet e transferimit të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit, nëpunësi civil, ka të drejtë të refuzojë vendimin e komisionit të ristrukturimit.

Në Vendimin nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil*”, në kreun II, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, pika 20 e tij parashikon:

“Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim. Nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit”.

Më tej, në pikën 21 përcaktohet:

“Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohej nga njësia përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, vetëm në rast se:

- a) Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;*
- b) Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil”.*

Ndërsa në pikën 35 parashikohet që, *“Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative dhe gjyqësore sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit, rezulton se, në të gjitha rastet e transferimit të përhershëm, nëpunësit nuk e kanë refuzuar transferimin. Në këtë rast, secili nëpunës, në mënyrë individuale, me shkrim i ka përcjellë njësisë përgjegjëse DAP mendimin se është dakord me transferimin.

Ndërkaq konstatohet se, janë ankuar në gjykatën kompetente dhe janë në proces gjyqësor punonjësit, të cilët janë liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, si, *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****. Pretendimet konkrete të paraqitura nga këta nëpunës, për parregullsitë e pretenduara gjatë procedurës së lirimit nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit, do të marrin zgjidhje përfundimtare nga Gjykata Administrative, si organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative që lindin gjatë një marrëdhënieje pune në shërbimin civil.

IV. Respektimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Departamenti i Administratës Publike.

Një moment tjetër i mbikëqyrjes së procesit të ristrukturimit të aplikuar pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është verifikimi i afateve të përcaktuara në legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Si rregull, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, njofton individualisht nëpunësit për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. Efektet financiare për nëpunësit që do të transferohen apo do t’u përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit (*pika 15 e kreut II, të VKM nr. 125, dt. 17.2.2016*). Rezulton se ky afat është respektuar nga Departamenti i Administratës Publike.

Më tej, është parashikuar se, nëpunësi më i lartë civil i institucionit në ristrukturim, jo më vonë se 2 ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar ristrukturimin, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit. Njësia përgjegjëse (DAP), brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës krijon Komisionin e Ristrukturimit (sipas përcaktimeve të pikave 1, 1/1 e 2, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Pasi krijohet nga njësia përgjegjëse, Komisioni Ristrukturimit brenda 15 ditëve, nga momenti i krijimit të tij, i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), vendimet mbi transferimin e nëpunësve civil (sipas përcaktimeve të pikës 16, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Në vazhdim, njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së propozimit për transferimin e nëpunësve civilë nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për miratimin e propozimeve në fjalë, ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërtetohet parregullsi ligjore, i cili e rishqyrton brenda 5 ditëve (sipas pikës 20, Kreu II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe pikës 18, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këtë rast, aktet nënligjore kanë parashikuar edhe njoftimin e vendimit të transferimit nëpunësit civil që transferohet dhe marrjen e mendimit të tij me shkrim brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit; të drejtën e nëpunësit që të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse brenda 5 ditëve dhe pas kësaj, rikthimin e akteve për rivlerësim Komisionit, i cili duhet të japë mendimin e tij brenda 5 ditëve (sipas pikës 20 e 21 të kreut II, të VKMnr. 125, datë 17.2.2016, si dhe pikës 19, 20 e 21 të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këto rrethana, nëse do të aplikoheshin të gjitha fazat e procesit të ristrukturimit, si dhe afatet procedurale të ankimit, si dhe duke llogaritur vonesat në marrjen e njoftimit nga subjektet e përcaktuara në aktet rregullative të përmendura më sipër, atëherë i gjithë ky proces parashikohet që të kryhet brenda një afati kohor që zgjat rreth 60 ditë kalendarike.

Referuar bazës ligjore si më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së veprimeve administrative në kuadër të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, duhet të respektohen edhe afatet procedurale të parashikuara për këtë rast.

Nga verifikimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit në këtë institucion, rezulton se, nga momenti i miratimit të strukturës së re, e konkretisht nga data 5.10.2017, e deri në daljen e vendimit për transferimin përhershëm të nëpunësve civilë brenda institucionit (data 16.11.2017); nxjerrja e akteve të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit (data 4.12.2017), si dhe sistemimi i nëpunësve të ish-Ministrisë së Integritimit në institucione të tjera (data 10.1.2018), rezulton se, procesi në dy fazat e para, është realizuar brenda afateve. Përsa

i përket sistemimit të nëpunësve të ish-MIE, për shkak se nga Komisioni i Ristrukturimit, janë shqyrtuar të gjitha mundësitë e sistemimit të tyre në institucione të tjera, në këtë rast, procesi i ka tejkaluar afatet.

Në dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e ristrukturimit, ligjvënësi ka përcaktuar të vendosë afatet procedurale të përmendura më sipër, për të disiplinuar këtë proces me qëllim që procesi të mos zvarritet. Megjithatë, vlen të theksohet se, afati i mësipërm ligjor shërben si një garant në kushtet e zhvillimit të një procesi ristrukturimi në rrethana të zakonshme. Në rastin konkret, për sa është pasqyruar në përmbajtje të këtij raporti, rezulton se, ndodhemi në kushtet e riorganizimit tërësor të aparatit shtetëror, i cili është shoqëruar me ndryshim të theksuar të mënyrës së funksionimit të ministrive, misionit të tyre si dhe të riformatimit të njësive organizative, fakt që kërkon një periudhë më të gjatë kohore të realizimit të procedurës së ristrukturimit.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në rastin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, tejkalmii afateve të caktuara në aktet nënligjore, ka ardhur si rezultat i faktit që ristrukturimi ka përfshirë dy institucione (ish-Ministrinë e Integritetit dhe Ministrinë e Jashtme), si dhe specifika e kësaj ministrie që, përveç statusit të nëpunësit civil, nëpunësit kanë edhe statusin diplomatik. Në këtë rast, Komisioni i Ristrukturimit, pas transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë brenda institucionit, ka shqyrtuar të gjitha mundësitë për të sistemuar nëpunësit e ish-MIE edhe në institucione të tjera dhe, nga ana tjetër, Departamenti i Administratës Publike, ka ushtruar kompetencat ligjore për verifikimin e zbatimit të legjislacionit civil gjatë vendimmarrjes së Komisionit të Ristrukturimit, me qëllim garantimin e të drejtave të nëpunësve civilë nëpërmjet një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në ligj.

V. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga punonjësi *** , për lirin e tij nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit.**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka ardhur në mënyrë elektronike kërkesa e protokolluar me nr. 111 prot., datë 22.1.2018, e punonjësit ***** , përmes së cilës ai e konsideron të padrejtë vendimin për lirin e tij nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, me pretendimin se, ekzistojnë pozicione vakante në përputhje me kualifikimet që ai ka.

Gjatë mbikëqyrjes së procesit të ristrukturimit në MEPJ, rezulton se, punonjësi ***** , është një ndër 13 nëpunës civilë të ish-MIE, për të cilët, Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Nga përmbajtja e materialeve të administruara, rezulton se, punonjësi ***** , ka kryer detyrën “*Specialist në Sektorin e Asistencës së BE-së, Monitorimit dhe Vlerësimit*”, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në ish-Ministrinë e Integritetit Evropian, i emëruar në këtë detyrë në datën 27.1.2017.

Ministria e Integritimit Evropian, në të cilën ka qenë punësuar ky punonjës, nuk ekziston më dhe funksionet e kësaj ministrie janë shkrirë në ish-Ministrinë e Punëve të Jashtme, sot Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Nga analiza e strukturës së MEPJ, rezulton që të gjitha funksionet e ish-MIE, janë përfshirë në vetëm 3 drejtori, konkretisht, *Drejtoria e BE-së, Drejtoria e Fondeve të BE-së dhe Drejtoria e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane.*

Konstatohet se, në *Drejtorinë e Fondeve të BE-së*, janë bashkuar funksionet e dy drejtorive të ish-MIE: Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së (ku punonjësi ***** kryente detyrën “Specialist”) dhe Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial. Këto dy drejtori kishin gjithsej **26** pozicione pune, ndërsa në strukturën e re, janë parashikuar **20** pozicione pune, pra, realisht janë shkurtuar **6** pozicione pune.

Drejtoria e Fondeve të BE-së, është e organizuar me këto pozicione pune: **1** Drejtor, **5** Përgjegjës Sektori dhe **14** Specialistë. Komisioni i ristrukturimit, në këto pozicione pune, ka sistemuar nëpunësit civilë të ish-MIE, përveç 1 pozicioni pune “Specialist”, në Sektorin e të Drejtës Evropiane, i cili rezulton vend i lirë.

Në rastin e punonjësit ***** komisioni i ristrukturimit, me vendimin nr. 10/1, datë 15.1.2018, pasi ka shteruar mundësitë për sistemimin e tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil, ka vendosur deklarin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, pasi, *nuk është i mundur transferimi i këtij nëpunësi civil në një pozicion të së njëjtës kategori, në të cilin plotëson kriteret e veçanta dhe ka përshkrim të njëjtë/të ngjashëm për nga funksionet që ky nëpunës ka kryer deri aktualisht në pozicionin e fundit.* Më pas, ka dalë akti nr. 11, datë 15.1.2018, i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të MEPJ, që e liron atë nga shërbimi civil.

Sipas pikës 1, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, *nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas një renditjeje me precedencë të përcaktuar në pikën 2 të tij, ...b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkrirë apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi:*

- c) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar;
- ç) në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Më tej, pika 3 e nenit 50 të ligjit, përcakton se:

“... Komisioni shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. ...”, ndërsa, sipas pikës 6:

Përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil, lejohet vetëm në rastin kur si pasojë e ristrukturimit, ka shkurtim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe transferimi, sipas pikës 2, është i pamundur.

Referuar kësaj baze ligjore, nga këqyrja e akteve, rezulton se, komisioni i ristrukturimit, në rastin e punonjësit ******, ka mbajtur në konsideratë kriteret e veçanta që plotësonte ky punonjës, si dhe përshkrimin e pozicionit ekzistues të punës, duke i krahasuar me kriteret dhe përshkrimet e punës së pozicioneve të reja apo të pozicioneve vakante, në shërbimin civil dhe ka konkluduar se, nuk rezulton asnjë vend i lirë në aparatën e kryeministrit dhe të ministrive të linjës, që përshtaten me këto kritere dhe që të jenë të së njëjtës kategori page III-b.

Përsa i përket vendit vakant, i cili ka rezultuar në përfundim të procesit të ristrukturimit në MEPJ, edhe në këtë rast, komisioni i ristrukturimit ka arsyetuar se ka qenë i pamundur sistemimi. Bëhet fjalë për pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e të Drejtës Evropiane*”, Drejtoria e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane pranë MEPJ, kategoria e pagës III-b.

Në lidhje me këtë rast, u administrua përshkrimi i punës për këtë pozicion pune, nga përmbajtja e të cilit, rezulton se, kërkesat e posaçme që duhet të plotësojë kandidati, janë: *arsimii lartë/Master Shkencor në shkencat juridike; 1 vit përvojë pune në shërbimin civil lidhur me fushën e përafrimit të legjislacionit të BE; të zotërojë gjuhën angleze në nivel të lartë, të vërtetuar me dëshmi përkatëse të njohur nga legjislacioni shqiptar në fuqi (përbën avantazh njohja e gjuhëve të tjera të huaja).*

Nga krahasimi i të dhënave personale të nëpunësit ******, me kërkesat e posaçme që kërkon pozicioni i punës si më sipër, rezulton se, ky nëpunës, *nuk e përmbush kriterin e nivelit arsimor.*

Në rastin konkret, arsimi i tij është Master Shkencor në “*Marrëdhënie Ndërkombëtare*” dhe Doktor Shkencash në “*Studime Politike*”, në Fakultetin e Shkencave dhe Sociologjisë, nëndega Histori e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në Universitetin “La Sapienza”, Romë, Itali. Ndërkohë, pozicioni i punës “*Specialist në Sektorin e të Drejtës Evropiane*”, kërkon arsimin e lartë juridik (master shkencor), pasi, një nga detyrat kryesore të këtij pozicioni pune, që lidhet dhe me qëllimin e përgjithshëm të pozicionit, është *të bashkërendojë, analizojë dhe monitorojë ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian*. Pra, kërkohen njohuri kryesisht në fushën e legjislacionit. Për më tepër, edhe përvoja në punë etij në shërbimin civil, në momentin e ristrukturimit, ka qenë më pak se 1 vit (i emëruar në shërbimin civil në datën 27.1.2017).

Gjithashtu, sistemimi në institucionet e shërbimit civil në varësi të ministrit ka qenë i pamundur, pasi ish-MIE dhe ish-MPJ, nuk kanë institucione varësie pjesë të shërbimit

civil. Nga ana tjetër, asnjë prej institucioneve të tjera të varësisë, nuk u përfshinë në procesin e ristrukturimit.

Në këto kushte, si dhe duke pasur parasysh kërkesat e ligjit, komisioni i ristrukturimit, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për punonjës in *****, duke i njohur të gjitha të drejtat e përcaktuara në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë si dhe e drejta që brenda një periudhe 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 e 26 të ligjit. Ndërkohë, konstatohet se, ky punonjës nuk është ankuar në gjykatën kompetente në lidhje me këtë vendim.

Në këto kushte, kur në përmbajtjen e informacionit, nuk evidentohen shkaqe ligjore për fillimin e hetimit administrativ, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 16, pika 2 dhe 6, Kreu III, “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.3.2017, të Komisionerit, ka vendosur arkivimin e çështjes.

VI. Konkluzione

Nga gjithë sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se, ngritja e Komisionit të Ristrukturimit, procedura e ndjekur prej tij për nxjerrjen e akteve administrative për propozimin e transferimit të nëpunësve civilë, për të cilët pozicionet e punës u prekën si rrjedhojë e ristrukturimit të administratës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe procedura e kryer nga Departamenti i Administratës Publike, deri në nxjerrjen e akteve administrative individuale për miratimin e transferimeve në fjalë, janë kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; e Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe kërkesat e Udhëzimit nr.1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

*
* *
*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil gjatë procesit të monitorimit të procedurave të kryera në kuadër të ristrukturimit të institucionit Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

KOMISIONERI
Pranvera Strakosha